



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

**RAPORTI VJETOR I PROGRESIT TË ZBATIMIT TË STRATGJISË PËR PËRMIRËSIMIN
E PLANIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT TË POLITIKAVE (SISTEMI I
PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR) PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2020**

PRILL 2021

Tabela e përmbajtjes

<i>Lista e akronimeve</i>	3
<i>Përmbledhja ekzekutive</i>	4
<i>Përmbledhje e zbatimit të përgjithshëm</i>	7
Zbatimi i masave të reformës së SPPKP në vitin 2020	10
Arritja e treguesve të nivelit të rezultateve për SPPKP	11
Procesi i përgatitjes së raportit të monitorimit	14
Aspekti financiar i zbatimit të Strategjisë	15
<i>Zbatimi i përgjithshëm i objektivave të Strategjisë</i>	16
Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike	16
Ndërlidhja më e mirë e dokumenteve strategjike dhe burimeve financiare	18
Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit	19
Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.	20
<i>Sfidat dhe rekomandimet</i>	21
<i>Shtojca 1. Tabela me zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit për vitin 2020</i>	22

Lista e akronimeve

UA	Udhëzimi Administrativ
OB	Organizata Buxhetore
PRE	Programi për Reforma në Ekonomi
PPQ(PVPQ)	Plani i Punës së Qeverisë
SKQ/ZPM	Sekretariati Koordinues i Qeverisë në Zyrën e Kryeministrit
IPAK	Instituti Kosovar për Administratë Publike
ML	Ministritë e Linjës
KASH	Korniza Afat-mesme e Shpenzime
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
PKZMSA	Programi Kombëtarë për Zbatimin e Mrrëveshjes së Stabilizim Asociimit
ZKZH/ZKM	Zyra për Koordinim të Zhvillimit në Zyrën e Kryeministrit
ZKPSA/ZKM	Zyra për Koordinimin e Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit në Zyrën e Kryeministrit
KPS	Komisioni për Planifikim Strategjik
GDPS	Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik
ZPS/ZKM	Zyra për Planifikim Strategjin në Zyrën e Kryeministrit

Përmbledhja ekzekutive

Ky është raporti i katërt vjetor mbi zbatimin e Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021 (SPPKP), më saktësisht zbatimit të Planit të Veprimit për vitin 2020. Raporti shqyrton secilën objektive strategjike dhe specifike duke analizuar progresin e arritur në zbatim për secilin aktivitet në kuadër të këtyre objektivave për periudhën 2020 si dhe përmbushjen e vlerave të synuara/caqeve të treguesve.

SPPKP 2017-2021, ashtu siç kërkohet me UA 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike deri më tani është zbatuar përmes një Plani të Veprimit tre vjeçar që ka mbuluar periudhën 2017- 2019. Pas përfundimit të kësaj periudhe zbatuese, në fund të vitit 2019, Zyra për Planifikim Strategjik ka ndërmarrë një rishikim të lehtë të Planit të Veprimit, për të identifikuar aktivitetet për periudhën 2020-20221, të cilat do të kontribuonin në arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të kësaj Strategjie. Duhet të theksohet se janë rishikuar vetëm aktivitetet ndërsa objektivat strategjike, ato specifike si dhe treguesit mbetën të njëjtat.

Si rezultat i këtij rishikimi, është hartuar Plani i Veprimit 2020-21, i cili është miratuar nga Qeveria e Kosovës më datë 22 korrik 2020. Prandaj, sa i përket periudhës raportuese një vjeçare, ky raport nuk mund të ofroj një pasqyrë sa i përket aktiviteteve për periudhën Janar-Qershor meqë është miratuar në muajin korrik 2020, megjithatë raporti ofron informata mbi progresin e përgjithshëm të proceseve të cilat janë zhvilluar gjatë 2020 dhe janë të ndërlidhura me zbatimin e Planit të Veprimit 2020-21.

Në përgjithësi, angazhimet e institucioneve në pajtueshmëri me Planin e Veprimit, kanë qenë në drejtim të zhvillimit të kornizës gjithëpërfshirëse të planifikimit dhe menaxhimit strategjik, duke u munduar që të përmirësohet ndërlidhja ndërmjet planifikimit strategjik dhe burimeve financiare. Koncepti i kornizës për planifikim dhe menaxhim strategjik i cili është miratuar bashkë me konceptin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 20302, e miratuar në Qeveri më datë 07 tetor 20203, synon të krijoj strukturën e sistemit të planifikimit strategjik, proceset e punës dhe dokumentet e planifikimit strategjik, dhe të rregulloj më mirë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qeveritare.

Vendosja dhe funksionalizimi i kësaj kornize të planifikimit dhe menaxhimit strategjik pritet të ndihmojë kryesisht në tejkalimin e problemeve që vijnë nga lidhjet jo të forta ndërmjet planifikimit të politikave dhe buxhetimit. Të gjitha politikat dhe aktivitetet e zbatuara nga sektori publik duhet të lidhen qartë me dokumentin përkatës të buxhetit dhe një objektive strategjik specifik në dokumentet kryesore strategjike, i cili në të njëjtën kohë përbën një nga objektivat kryesore të SPPKP 2017-2021. Poashtu, me vendosjen e kësaj kornize synohet të përmirësohet i gjithë cikli i planifikimit të politikave strategjike dhe menaxhimi i tyre, duke rezultuar më një planifikim më cilësorë dhe zbatim më të mirë të tyre.

Sa i përket përmirësimit të nivelit të zbatueshmërisë së SPPKP 2017-2021 dhe përmbushjes së objektivave strategjike, mbetet që në vazhdim të punohet në finalizimin e jetësimit të kornizës së konsoliduar për planifikim dhe menaxhim strategjik, duke përfshirë: përfundimin e hartimit dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim me afat dhjetëvjeçar 2030, që do të jetë dokumenti kryesor ombrellë strategjik me të cilin do të ndërlidhen të gjitha dokumentet strategjike sektoriale dhe ato nga agjenda horizontale; përdorimi i sektorëve të politikave si parakusht për të zhvilluar lidhjen me dokumentet kyçe buxhetore, siç janë korniza afatmesme buxhetore (KASH) dhe buxheti vjetor; konsolidimi i kornizës ekzistuese të planifikimit, duke përfshirë vendosjen e hierarkisë së objektivave në dokumente të ndryshme strategjike, dhe duke i lidhur me dokumentet buxhetore; sigurimi i zbatimit të kornizës së planifikimit strategjik sektorial nëpërmjet zbatimit të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe


¹ <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/09/Vendimet-nga-mbledhja-e-15-t%C3%AB-e-Qeveris%C3%AB.pdf>

² <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/12/Koncepti-per-hartimin-e-Strategjise-Kombetare-per-Zhvillim-2030.pdf>


³ <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/12/Vendimi-per-pergatitjen-e-Strategjise-Kombetare-per-Zhvillim.pdf>

Planeve të Veprimit; krijimi i lidhjeve më të forta mes planifikimit strategjik dhe kornizës buxhetore, duke përmirësuar koordinimin mes palëve kryesore ZPS-së dhe MF-së, si dhe organizatave të tjera buxhetore (OB), kryesisht ministri të linjës; strukturat e planifikimit strategjik si Komisioni për Planifikim Strategjik dhe Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik të orientohen drejt një bashkëpunimi më të ngushtë dhe më gjithëpërfshirës mes ZPS-së, MF-së dhe ministrive kryesore të linjës/OB-ve.

Megjithatë, sa i përket zbatimit të përgjithshëm të aktiviteteve nga Plani i Veprimit të SPPKP për periudhën raportuese, në përgjithësi nuk është arritur një zbatueshmëri e kënaqshme; nga të dhënat shihet se në vitin 2020, 35% e aktiviteteve të parapara me planin e veprimit janë zbatuar, 65% janë zbatuar pjesërisht, janë në proces të zbatimit apo nuk kanë filluar së zbatuari ende.



Më konkretisht, në kuadër të objektivave strategjike, gjithsej katër objektiva strategjike që i përmban strategjia, nga total 31 aktivitete të planifikuara për vitin 2020, dhe pothuajse në kuadër të të gjitha objektivave specifike ka aktivitete që nuk ka filluar zbatim, ndërsa pjesa tjetër e aktiviteteve janë pjesërisht të zbatuara apo janë zbatuar plotësisht.



Ndër arsyt e kësaj përqindje jo të kënaqshme të zbatueshmërisë së Planit të Veprimit janë pandemia Covid 19, e cila në përgjithësi ka shkaktuar vonesa nga më të ndryshmet në punën e Qeverisë dhe institucioneve poashtu edhe duke shmangur vëmendjen nga proceset e reformave të ndryshme kryesisht duke e vendosur në qështjet që kanë të bëjnë lidhur me menaxhimin e masave për mbrojtje nga Covid 19 dhe programet ekonomike për rimëkëmbje ekonomike. Poashtu, ndikim ka patur edhe zgjedhjet e parakohshme të organizuara në vend dhe ndërrimi i dy Qeverive brenda një viti (2020).

Sidoqoftë, bazuar në progresin e arritur në përbushjen e caqeve të treguesve të prezantuara në vazhdim të raportit dhe bazuar në zbatimin e aktiviteteve në përgjithësi në kuadër të SPPKP 2017-21 deri më tani, arrihet në konkludimin se duhet vazhduar me zbatimin e reformave që synojnë përmirësimin e sistemit të planifikimit dhe menaxhimit strategjik në Kosovë dhe adresimin e disa prej boshllëqeve aktuale përfshirë edhe atë të ngritjes së kapaciteteve.

Zbatimi i një kornize të planifikimit dhe menaxhimit strategjik kombëtar do të ndihmojë në tejkalimin e problemeve që vijnë nga lidhjet jo të forta ndërmjet planifikimit të politikave dhe buxhetimit. Të gjitha politikat dhe aktivitetet e zbatuara nga sektori publik duhet të lidhen qartë me dokumentin përkatës të buxhetit dhe objektivat strategjike dhe specifike në dokumentet kryesore strategjike, kjo edhe përbën një nga objektivat kryesore të SPPKP 2017-2021.

Për më shume, në vazhdim të raportit, gjeni më në detaje arritjet e zbatimit si dhe pengesat dhe sfidat kryesore në përbushjen e këtyre planifikimeve në kuadër të Planit të Veprimit 2020-21.

Ndërsa, sa i përket përgatitjes së këtij raporti vjetor, të gjitha palët e përfshira në zbatim të Planit të Veprimit kanë qenë në komunikim të ngushtë dhe kanë ndarë informacione në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe raportimin e progresit të arritur gjatë periudhës raportuese, kështu që ka pasur një proces të mirë komunikimi dhe konsultimi të brendshëm gjatë përgatitjes së raportit.

Në lidhje me aspektin financiar për zbatimin e Strategjisë, ashtu siç ishte paraparë në momentin e miratimit të Strategjisë, por edhe rishikimit të Planit të Veprimit 2020-21, zbatimi i strategjisë mbështet nga donatorët, përmes mbështetjes ekzistuese të BE, SIDA dhe GIZ si dhe një pjesë e kostos që është e lidhur me kostot e tjera brenda buxhetit ekzistues të planifikuar në ZKM në zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë.

Përmbledhje e zbatimit të përgjithshëm

Ky seksion ofron dhe pasqyron zhvillimet kryesore gjatë periudhës së raportimit, në veçanti nënvizon përparimin e përgjithshëm të reformës, përfshirë edhe procesin e përgatitjes së raportit të monitorimit.

Në kontekstin e zbatimit të përgjithshëm të SPPKP gjatë vitit 2020, në lidhje me Objektivin Strategjik 1, ka një vazhdimësi të përparimit të procesit të koordinimit të politikave që është siguruar si rezultat i zbatimit të SPPKP 2017-21. Në terma të veçantë, janë bërë analiza dhe propozime të cilat pritet të finalizohen gjatë 2021, siq janë definimi i sektorëve dhe fushave të politikave dhe propozimet për përfshirje të tyre në Rregulloren e PPQ, skanimi i të gjitha dokumenteve strategjike ekzistuese dhe propozimi i sistemit të dokumenteve strategjike për miratim, në këtë drejtim, poashtu është përfunduar një hartësim i strategjive ekzistuese dhe Konceptit të Planifikimit dhe Menaxhimit Strategjik në Kosovë, i cili ofron një propozim për sistemin e dokumenteve strategjike në Kosovë, përfshirë edhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030; harmonizimi dhe lidhja ndërmjet dokumenteve strategjike dhe atyre financiare siq është KASH dhe Programi për Reforma në Ekonomi; progres është arritur në drejtim të forcimit të kornizës së planifikimit strategjik përmes zbatimit të UA 07/2018 në planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike, në veçanti shqyrtimin dhe zbatimin e kërkesave për propozimet për dokumente të reja strategjike; krijimit të ekipeve të përbashkëta nga Ministritë e Linjës dhe QeQ të cilat të njëjtat ekipe që punojnë në përgatitjen e PPQ dhe PKZMSA.

Poashtu, strukturat për planifikim strategjik (Komisioni për Planifikim Strategjik, Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik) gjatë kësaj periudhe janë ri funksionalizuar përmes një vendimi të ri të Qeverisë ku janë rishikuar funksionet KPS dhe GDPS, me këtë rast edhe Këshilli Kombëtar për Investime është shkrië në KPS, kjo si pasojë edhe e ndryshimeve në strukturën e Qeverisë, ku Ministria e Integritimit Evropian ka kaluar si strukturë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Sidoqoftë, në nivelin teknik koordinimi i proceseve të planifikimit ka funksionuar siç duhet (psh. së pari, procesi i hartimit të KASH-it ka treguar një nivel të madh koordinimi midis ZKM-së dhe MF-së dhe së dyti, hartimi i PRE-së siguroi koordinimin e duhur në Qendër të Qeverisë - ZKM, MF dhe me ministritë e linjës. Mirëpo, Grupet e Menaxhimit Strategjik, të parashikuara të themelohen nga ministritë e linjës nuk janë krijuar ende.

Sa i përket Objektivit Strategjik 2, është duke u bërë një përmirësim i ngadalshëm në drejtim të sigurimit të një lidhje më të mirë të prioritetëve strategjike me buxhetin, kryesisht përmes Deklaratës së Prioritetëve dhe gjithashtu prezantimit të treguesve të performancës në ligjin e buxhetit, edhe pse dokumentet kryesore të planifikimit financiar (Deklarata e Prioritetëve, KASH dhe Buxheti Vjetor), nuk janë rishikuar nga strukturat e planifikimit strategjik, sepse ri funksionalizimi i strukturave është bërë pas përfundimit të këtyre proceseve. Ndërsa, nuk ka patur progres të prekshëm përkundër se janë bërë propozimet fillestare për hartimin e një udhëzuesi për përgatitjen e Deklaratës së Prioritetëve Afatmesme dhe nevoja për përcaktimin e këtij procesi edhe në RrP të Qeverisë si dhe hartimi i metodologjisë për Planin Institucional (PI) përmes shembujve pilot (3 shembuj) të Organizatave Buxhetore.

Në anën tjetër, është siguruar mbulimi me buxhetin vjetor të masave afatshkurtra të PKZMSA-së, ndërsa aplikimi i kostimit të masave afatmesme të PKZMSA-së që është planifikuar të pilotohet në 2-3 ministri ose fusha sektoriale nuk është realizuar.

Progres jo edhe aq i kënaqshëm është arritur nën Objektivin Strategjik 3, veçanërisht si rezultat i vonësve që janë bërë në finalizimin e disa aktivitetëve që kanë qenë të ndërlidhura pastaj me plotësim/ndryshimin e RrPQ, këto kryesisht lidhen me përcaktimin e kërkesave të përgjithshme të raportimit për dokumentet e planifikimit qendror; koncepti për monitorimin e PPQ si kanal i vetëm monitorimi për të gjithë dokumentet e planifikimit strategjik poashtu; publikimin e dokumenteve të politikave, përfshirë raportet për zbatimin e tyre; harmonizimi i përdorimit të treguesve të performancës në nivel rezultati në Planin e Punës së Qeverisë me SKZH, PRE dhe treguesit e tjerë të strategjive sektoriale; mbikëqyrja dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të PKZMSA-së, përfshirë (sipas nevojës) përmes strukturave të MSA.

Ndërsa, në lidhje me Objektivin Strategjik 4. Përmirësimi i aftësive të administratës për planifikimin dhe koordinimin e politikave, si pasojë e pandemisë Covid 19, në përgjithësi aktivitetet trajnuese nuk janë zhvilluar sipas planifikimeve. Megjithatë, ka patur disa zhvillime si hartimi i moduleve të trajnimit për Planifikimin Strategjik mirëpo nuk është bërë edhe trajnimi i trajnerëve bazuar në kurrikulën e re; organizimi

dhe sigurimi i trajnimeve për zbatimin e MSA-së; organizimi dhe sigurimi i trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve të administrates për menaxhimin e ndihmës së jashtme, si pjesë e rregullt e programeve të siguruar nga IKAP; ndërsa nuk është arritur të bëhet trajnimi i anëtarëve të grupeve të punës të përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike.


Tabela në vazhdim, paraqet një përmbledhje të nivelit të zbatimit të masave të planifikuara brenda katër objektivave strategjike të SPPKP.

Nr	Objektivat strategjike	Masat e planifikuara	Te zbatuara	Nuk/ Duke u zbatuar
1	Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, duke përmirësuar ndërlidhjen e dokumenteve strategjike, nëpërmjet koordinimit dhe vendimmarrjes më të mirë.	10	5	5
2	Ndërlidhja më e mirë e kornizës për planifikim strategjik me planifikimin e resurseve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përballueshmërinë financiare dhe zbatimin e planeve strategjike.	4	0	4
3	Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit për të siguruar rezultate më të mira të zbatimit dhe llogaridhënies për përmbushjen e objektivave të vendosura të Qeverisë.	6	0	6
4	Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.	5	3	2
TOTALI		25	8	17

Nëse shikojmë progresin e zbatimit nga aspekti i institucioneve përgjegjëse, me plotësim ndryshimin e Rregullores (QRK) - Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive 4 me kalimin e Ministrisë për Integrim Evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, atëherë mbi 95% e zbatimit të këtij Planit të Veprimit bie si përgjegjësi e ZKM. Për zbatimin e aktiviteteve, vërehet se të gjitha institucionet/zyrat kryesisht kanë aktivitete të zbatuara dhe në zbatim më shumë se ato që nuk kanë filluar zbatimin, me përjashtim ZPS ka disa aktivitete të parealizuara të shtrira në kuadër të katër objektivave strategjike të cilat kanë të bëjnë kryesisht me reformën e planifikuar përmes vendosjes në zbatim të Kornizës për Planifikim Strategjik, e që ndërlidhet poashtu me rishikimin e rregullativës ekzistuese në fuqi siq është Rregullorja e Punës së Qeverisë si dhe UA/07 2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike. Në vazhdim gjeni figurën 4. me të dhënat për zbatimin e aktiviteteve sipas institucioneve/zyrave përgjegjëse.

⁴ https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/02/Rregullore-Nr.-05_2020-p%C3%ABr-Fushat-e-P%C3%ABrgjegj%C3%ABsis%C3%AB-Administrative-t%C3%AB-Zyr%C3%ABs-s%C3%AB-Kryeministrit-dhe-Ministrive.pdf

Shkalla e zbatimit të aktiviteteve sipas institucioneve përgjegjëse



Zhvillimet në lidhje me kornizën e planifikimit dhe menaxhimit strategjik, kanë përcaktuar edhe shtrirjen e zbatimit të Planit të Veprimit të SPPKP për periudhën 2020-2021. Kështu, përqendrimi ka qenë në avancimin e mëtutjeshëm të sistemit i cili do të bazohet duke prezantuar procesin, dispozitat përkatëse rregullative, përmes ndryshimeve të planifikuara ne RrPQ dhe UA 07/2018, përshkrimin e informacionit/fushëveprimin dhe vendimet se si përdoret ai informacion për zbatimin e hapave të ardhshëm në proces. Për t'i arritur këto, ndryshimi i Rregullores së Punës së Qeverisë siguron një moment të mirë për të prezantuar disa elementë që mungojnë në sistemin e planifikimit dhe zbatimin e disa prej atyre ekzistuese. Kjo lidhet veçanërisht me përcaktimin e hierarkisë së dokumenteve të planifikimit të politikave, tipologjia e tyre, monitorimi dhe raportimi, funksionimin e strukturave të planifikimit strategjik, duke përfshirë krijimin e GMS-ve në secilën Ministri të linjës; hartimi, miratimi dhe zbatimi i Kalendarit të Planifikimit të Integruar.

Për më shumë, për përmirësimin e nivelit të zbatueshmërisë së SPPKP 2017-2021 dhe përmbushjes së objektivave strategjike, mbetet që ZPS me mbështetje edhe të asistencës teknike në dispozicion, në vazhdim të punoj në vendosjen e një kornize të konsoliduar për planifikim dhe menaxhim strategjik, duke përfshirë:

- ✓ Hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim me afat dhjetëvjeçar, që do të jetë dokumenti kryesor ombrellë strategjik me të cilin do të ndërlidheshin të gjitha dokumentet strategjike sektoriale dhe ato nga agjenda horizontale.
- ✓ Përcaktimi i sektorëve si parakusht për të zhvilluar lidhjen me dokumentet kyçe buxhetore, siç janë korniza afatmesme buxhetore (KASH) dhe buxheti vjetor.
- ✓ Konsolidimi i kornizës ekzistuese të planifikimit, duke përfshirë vendosjen e hierarkisë së objektivave në dokumente të ndryshme strategjike, dhe duke i lidhur me dokumentet buxhetore.
- ✓ Sigurimi i zbatimit të kornizës së planifikimit strategjik sektorial nëpërmjet zbatimit të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.
- ✓ Krijimi i lidhjeve më të forta mes planifikimit strategjik dhe kornizës buxhetore, duke përmirësuar koordinimin mes palëve kryesore ZPS-së dhe MF-së, si dhe organizatave të tjera buxhetore (OB), kryesisht ministri të linjës.

Zbatimi i masave të reformës së SPPKP në vitin 2020

Ky seksion ofron një përmbledhje të detajuar të statusit të zbatimit të masave të planifikuara të reformës SPPKP për vitin 2020. Siç është vërejtur, pandemia Covid-19 dhe ndërrimi i dy Qeverive kishte një ndikim të rëndësishëm në zbatimin e masave të reformës, megjithatë pavarësisht kësaj progres i rëndësishëm mund të vërehet.

Tabela 1: Një përmbledhje e shkallës së zbatimit të masave të planifikuara të reformës në vitin 2020

Tabela më poshtë ofron informacion të detajuar mbi statusin e zbatimit të aktiviteteve që ishin planifikuar për vitin 2020. Një shënim anësor, statusi nuk është zbatuar përfshin aktivitete që kanë filluar të zbatohen por nuk janë finalizuar gjatë periudhës së planifikuar, për informacione më specifike mbi ecurinë e zbatimit të aktivitetit, ju lutem shikoni Aneksin 1.

Nr	Aktivitetet	Instit.pergjegjes	Statusi
Objektivi strategjik #1: Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, duke përmirësuar ndërlidhjen e dokumenteve strategjike, nëpërmjet koordinimit dhe vendimmarrjes më të mirë.			
Objektivi Specifik 1.1: Ndërlidhja e dokumenteve kryesore strategjike me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe sigurimi i zbatimit të saj			
1.1.1	Përkufizimi i tipologjisë dhe hierarkisë së dokumenteve të planifikimit strategjik në Rregulloren e Punës së Qeverisë (RrPQ) së Kosovës.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
1.1.2	Plotësim/ndryshimi në UA 07/2018 sipas nevojave për zbatimin e Kornizës për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik dhe harmonizimi me intervenimet e bëra në RrPQ.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
1.1.3	Riformulimi i Tabelës A të PPQ me prioritetet që janë të definuara sipas SKZH, Programit të Qeverisë dhe vendosja e referencës përkundrejt objektivave strategjike dhe specifike të SKZH dhe strategjive sektoriale.	SPO/OPM	Plotësisht e zbatuar
1.1.4	Rishikimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) ekzistuese dhe hartimi i propozimit për SKZH e ardhshme.	SPO/OPM	Plotësisht e zbatuar
Objektivi Specifik 1.2: Përmirësimi i planifikimit strategjik të politikave për përbushjen e detyrimeve të MSA			
1.2.1	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet PKZMSA dhe PPQ – përmes miratimit të PKZMSA dhe PPQ në të njëjtën kohë (ZKM siguron ndërlidhjen gjatë rishikimit përfundimtar para miratimit në Qeveri).	OCSPA/OPM	Nuk është zbatuar.
1.2.2	Themelimi i ekipeve të përbashkëta nga Ministrinë e Linjës dhe QeQ të cilat do të jenë të njëjtat ekipe që punojnë në përgatitjen e PPQ dhe PKZMSA.	OCSPA/OPM	Plotësisht e zbatuar
Objektivi Specifik 1.3: Konsolidimi i Kornizës së Strategjive Sektoriale.			
1.3.1	Definimi i sektorëve / fushave të politikave të ndërlidhura me klasifikimin funksional sipas COFOG dhe përfshirja e këtyre definicioneve në UA 07/2018.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
1.3.2	Skanimi i të gjitha dokumenteve strategjike ekzistuese dhe propozimi i sistemit të dokumenteve strategjike për miratim.	SPO/OPM	Plotësisht e zbatuar
Objektivi Specifik 1.4: Përmirësimi i procesit të koordinimit dhe vendimmarrjes në nivel qendror dhe në nivelin e ministrive.			
1.4.1	Rishikimi i vendimeve për rolin dhe përgjegjësitë e Komisionit për Planifikim Strategjik (KPS) dhe Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS).	SPO/OPM	Plotësisht e zbatuar
1.4.2	Përgatitja e vendimit dhe themelimi i Grupeve për Menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Linjës të udhëhequra nga Ministri.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
Objektivi strategjik #2: Ndërlidhja më e mirë e kornizës për planifikim strategjik me planifikimin e resurseve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përbalueshmërinë financiare dhe zbatimin e planeve strategjike.			
Objektivi Specifik 2.1: Përmirësimi i orientimit strategjik të KASHit/buxhetit.			
2.1.1	Hartimi i një udhëzuesi për përgatitjen e Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme dhe përcaktimi i këtij procesi edhe në RrP të Qeverisë.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
2.1.2	Hartimi i metodologjisë për Planin Institucional (PI) përmes shembujve pilot (3 shembuj) të Organizatave Buxhetore.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.

Objektivi Specifik 2.2: Përmirësimi i buxhetimit afatmesëm dhe afatshkurtër, me qëllim të përbushjes së detyrimeve të MSA-së.			
2.2.1	Aplikimi i kostimit të masave afatmesme të PKMZSA-së pilotuar në 2-3 ministri ose fusha sektoriale.	OCSAP/OPM	Nuk është zbatuar.
Objektivi Specifik 2.3: Menaxhimi efektiv i ndihmës së jashtme			
2.3.2	Përgatitja e raportit vjetor për projektet të financuara nga donatorët e AJ-së (duke theksuar rezultatet e arritura kundrejt atyre të pritshme dhe kontributet e asistencës së jashtme).	OCD/OPM	Nuk është zbatuar.
Objektivi strategjik #3: Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit për të siguruar rezultate më të mira të zbatimit dhe llogaridhënies për përbushjen e objektivave të vendosura të Qeverisë.			
Objektivi Specifik 3.1: Përmirësimi i monitorimit të strategjive sektoriale duke përfshirë vlerësimin periodik të tyre.			
3.1.1	Mbështetje për Ministrinë e Linjës për hartimin e raporteve vjetore të monitorimit për zbatimin e strategjive të sektorit..	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
3.1.2	Përcaktimi i kërkesave të përgjithshme të raportimit për dokumentet e planifikimit qendror në RRP.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
3.1.3	Dizajnimi i formatit dhe aplikimi i monitorimit të zbatimit të PPQ të jetë kanal i vetëm monitorimi për të gjithë dokumentet e planifikimit strategjik.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
3.1.4	Hartimi i konceptit për krijimin e një faqe interneti qendrore për publikimin e dokumenteve të politikave, përfshirë raportet për zbatimin e tyre.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
Objektivi Specifik 3.2: Fuqizimi i rolit të sistemit të monitorimit të PVPQ-së si mekanizëm për informim të politikëbërësve dhe rritjes së llogaridhënies të ML.			
3.2.4	Harmonizimi i përdorimit të treguesve të performancës në nivel rezultati në Planin e Punës së Qeverisë me SKZH, PRE dhe treguesit e tjerë të strategjive sektoriale.	SPO-GCS/OPM	Nuk është zbatuar.
3.2.5	Mbikëqyrja dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të PKZMSA-së, përfshirë (sipas nevojës) përmes strukturave të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit dhe forcimin e strukturave kombëtare të koordinimit për Integrimin Evropian si një mekanizëm llogaridhënës.	OCSAP/OPM	Nuk është zbatuar.
Objektivi strategjik #4: Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.			
Objektivi specifik 4.1: Plotësimi me personelin e nevojshëm për planifikimin dhe koordinimin e politikave			
4.2.1	Rishikimi i moduleve ekzistuese të trajnimit për Planifikimin Strategjik dhe trainimin e trajnerëve bazuar në kurrikulën e re të zhvillimit të strategjisë.	SPO/OPM & KIPA	Plotësisht e zbatuar
4.2.2	Trajnimi i anëtarëve të grupeve të punës të përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike sipas viteve përkatëse.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
4.2.3	Trajnimi i stafit të ministrive për përgatitjen e Programit të Reformës Ekonomike, zhvillimin e treguesve të performancës dhe koston e masave strukturore.	SPO/OPM	Nuk është zbatuar.
4.2.4	Organizimi dhe sigurimi i trajnimeve për zbatimin e MSA-së.	OPM & KIPA	Plotësisht e zbatuar
4.2.5	Organizimi dhe sigurimi i trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve të administratës për menaxhimin e ndihmës së jashtme, si pjesë e rregullt e programeve të siguruara nga IKAP.	OPM & KIPA	Plotësisht e zbatuar

Arritja e treguesve të nivelit të rezultateve për SPPKP

Në lidhje me arritjen e rezultateve të planifikuara nga SPPKP, gjatë periudhës raportuese është e rëndësishme të theksohet se Strategjia e re e ardhshme e Zhvillimit Kombëtar (SKZH), e cila është në hartim e sipër, do të përfshijë prioritetet strategjike për më shumë sektorë, pasi SKZH aktuale nuk përfshin të gjithë sektorët e politikave, kështu që lidhja me Planin e Punës së Qeverisë (PPQ) është në një nivel të ulët. SKZH-

ja e re gjithashtu do të përmirësojë edhe ndërlidhjen me Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), i cili aktualisht është i ulët.

Progresi rëndësishëm është vërejtur në nivelin e harmonizimit të masave të zbatimit të PKZMSA me Programin e Punës së Qeverisë, i cili aktualisht raportohet në 89.61%, ndërsa sa i përket numrit të masave 69 nga 77 masat e planifikuara në PKZMSA për të cilat institucionet qeveritare janë përgjegjëse janë pjesë e PPQ. Niveli i përgjithshëm i harmonizimit të PKZMSA 2020 me Programin e Punës së Qeverisë, përfshirë Programin Legjislativ është në 93.75%, gjithashtu në një nivel shumë të knaqshëm. Një zhvillim tjetër pozitiv është niveli i zbatimit të masave të planifikuara nga Agjenda Evropiane e Reformës (ERA), e cila është në 74.1%. Gjatë vitit 2020, shumë nga fokusi i Zyrës së Kryeministrit ka qenë në zhvillimin e ERA 2. Në këtë drejtim, miratimi dhe zbatimi i tij është shtyrë për shkak të ndryshimit të qeverisë në qershor të vitit 2020 dhe zgjedhjeve të parakohshme të mbajtura në dhjetor. Një progres rëndësishëm mund të raportohet në zhvillimin e kapaciteteve për MSA dhe planifikimin dhe koordinimin e politikave. Në vitin 2020, numri i trajnerëve të certifikuar për planifikimin dhe zbatimin e MSA-së dhe zhvillimin e politikave është 49.

Një sfidë e vazhdueshme mbetet aftësia e institucioneve për të llogaritur në mënyrë objektive nivelin e masave të PKZMSA që pasqyrohen në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), për shkak të mungesës së mekanizmave për të siguruar analiza adekuate, megjithatë bazuar në informacionin të siguruar nga institucionet përgjegjëse KASH pasqyron përparësitë e PKZMSA. Një zhvillim rëndësishëm pozitiv i referohet PKZMSA-s së re 2021-2025 e cila ka gjithsej 302 masa afatshkurtra dhe të gjitha (100%) janë të buxhetuara, nga të cilat 18 me kosto administrative dhe 284 me kosto specifike buxhetore nga buxheti 2021 përfshirë gjithashtu burimet e ndihmës së jashtme.

Programi i Asistencës për Zhvillim (PAZH), i cili identifikon përparësitë dhe projektet për financim nga komuniteti i donatorëve, nuk është hartuar dhe aprovuar për vitin 2020, i cili është një parakusht për llogaritjen e përqindjes së Programit të Ndihmës për Zhvillim të aprovuar dhe i lidhur me KASH. Nga ana tjetër, KASH nuk përmban informacion të përmbledhur për përqindjen e mbulimit të përparësive të vendit nga PAZH. Lista e Projekteve Prioritare është diskutuar dhe shqyrtuar nga KPS, si një listë e shkurtër e projekteve më të rëndësishme të infrastrukturës që mund të zbatohen gjatë katër viteve të ardhshme dhe që mund të financohen nga Bashkimi Evropian, në kombinim me institucionet financiare ndërkombëtare.

Gjithashtu, një zhvillim tjetër pozitiv në vitin 2020 përfshin shkallën e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara në Programin e Punës së Qeverisë, duke marrë parasysh ndikimin e pandemisë Covid-19 dhe nderrimin e dy Qeverive në vend. Gjatë vitit 2020, nga 991 aktivitete të planifikuara në Planin e Punës së Qeverisë, 521, ose 52.6% janë zbatuar plotësisht, ndërsa 336 (33.9%) janë zbatuar pjesërisht, dhe pjesa tjetër 134 (13.5%) nuk kanë filluar zbatimin, edhe pse treguesi nuk ka arritur cakun e synuar në uljen e grumbullimit të aktiviteteve të bartura nga viti paraprak. Tabela më poshtë ofron informacion të detajuar mbi statusin e secilit tregues të nivelit të rezultatit nga SPPKP.

Tabela 2: Përmbledhje e statusit të arritjes së treguesve të nivelit të rezultateve nga SPPC

Nr	Treguesi	Baza	Targeti	Gjendja 2020	Statusi
Objektivi strategjik # 1: Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, duke përmirësuar ndërlidhjen e dokumenteve strategjike, nëpërmjet koordinimit dhe vendimmarrjes më të mirë.					
1	Përqindja e ndërlidhjes së Planit Vjetor të Punës së Qeverisë me SKZH (përmes Udhërrëfyesit për zbatimin e SKZH-së).	40%	60%	48%	Nuk është arritur.
2	Përqindja e ndërlidhjes së PKZMSA-së me SKZH (përmes Udhërrëfyesit për zbatimin e SKZH).	0%	60%	15%	Nuk është arritur.
3A	Përqindja e masave afatshkurtra të PKZMSA-së të reflektuara në PVPQ	58%	80%	89.61%	E arritur.

3B	Përqindja e masave afatshkurtra të PKZMSA që pasqyrohen në PVPQ (përfshirë edhe Programin Legjislativ të Qeverisë);	67%	80%	93.75%	E arritur.
4	Shkalla e zbatimit të Planit të Veprimit të Agjendës për Reforma Evropiane	0%	70%	74.1%	E arritur.
5	Shkalla e zbatimit të masave afatshkurtra të PKZMSA-së	40%	70%	41.64%	Nuk është arritur.
6	Numri i strategjive të miratuara që dalin nga SKZH në raport me strategjitë e miratuara jashtë fushëveprimit të SKZH-së.	0%	30%	30%	E arritur.
7	Shkalla e strategjive të miratuara para vitit 2016 të konsoliduara me kornizën strategjike.	0%	20%	50%	E arritur.
8	Numri i ministrive që kanë adaptuar strukturat sipas IPS dhe kalendarin e integruar.	0	7	0	Nuk është arritur.
9	Përqindja e zbatueshmërisë së Kalendarit të Planifikimit të Integruar.	0%	50%	0%	Nuk është arritur.
Objektivi strategjik #2: Ndërlidhja më e mirë e kornizës për planifikim strategjik me planifikimin e resurseve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përbalueshmërinë financiare dhe zbatimin e planeve strategjike.					
10	Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të.	7.5%	6.5%	Të dhënat të merren nga raporti SRMFP	Nuk është arritur.
11	Përqindja e mbulimit të veprimeve të SKZH-së në KASH (përmes udhërrëfyesit për zbatimin e SKZH-së).	40%	60%	65%	E arritur.
12	Raporti ndërmjet fondeve të përgjithshme të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe financimit të përgjithshëm të identifikuar për sektorët përkatës në KASH.	20%	40%	Mungojnë të dhënat.	Nuk është arritur.
13	Kërkesat e kalendarit të Sistemit për Planifikim të Integruar janë përmbushur për planifikimin financiar, duke përfshirë programin për investime kapitale.	No requirement	IPS calendar req. met.	Nuk ka progres	Nuk është arritur.
14	Përqindja e prioriteteve kryesore të PKZMSA-së të reflektuar në KASH.	0%	80%	Nuk ka të dhëna.	Nuk është arritur.
15	Përqindja e masave afatshkurtra të PKZMSA-së të mbuluara me buxhet vjetor përgjatë tërë vitit.	45%	80%	100%	E arritur.
16	Programi për Asistencën Zhvillimore i miratuar dhe i ndërlidhur me KASH i shprehur në përqindjen e mbulimit të prioriteteve.	0%	50%	Mungojnë të dhënat.	Nuk është arritur.
17	Përqindja e ndërlidhjes së Projekteve nga Lista e Projekteve Prioritare me prioritetet e SKZH-së	0%	70%	60%	Nuk është arritur.
Objektivi strategjik #3: Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit për të siguruar rezultate më të mira të zbatimit dhe llogaridhënies për përmbushjen e objektivave të vendosura të Qeverisë.					
18	Përqindja e strategjive sektoriale që kanë raporte vjetore të hartuara dhe publikuara.	0%	40%	0%	Nuk është arritur.
19	Raportet vjetore të strategjive të zhvilluara sipas Udhëzimit Administrativ të	0%	80%	Nuk ka të dhëna.	Nuk është arritur.

	rishikuar, po ashtu përfshijnë informata rreth arritjeve kundrejt objektivave (produktet/rezultatet).				
20	Çështjet e pakryera në zbatimin vjetor nga zotimet e planifikuara në dokumentin(et) e planifikimit në nivelin qendror (përqindja e zotimeve të përgjithshme të PVPQ-së të bartura në vitin vijues).	26%	15%	47.3%	Nuk është arritur.
21	Indikatorët e performancës janë zhvilluar dhe përfshirë në PVPQ.	Indikatorët e Perf. mungojnë në PPQ	Indikatorët e Perf. të përfshira në PPQ	Te përfshira në PPQ.	E arritur.
22	Çështjet e pakryera në zbatimin vjetor nga zotimet e planifikuara në PKZMSA (përqindja e zotimeve të përgjithshme të PKZMSA-së të bartura në vitin vijues).	0%	25%	42.56%	Nuk është arritur.
Objektivi strategjik #4: Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmeve koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.					
23	Numri i trajnerëve të certifikuar për planifikimin dhe zbatimin e MSA-së dhe zhvillimin e politikave.	0	15	49	E arritur.
24	Kapacitetet për zhvillim të politikave në kuadër të institucioneve të Qendrës së Qeverisë dhe të gjitha ministrat e linjës janë ngritur përmes programeve trajnuese dhe programeve për trajner.	0%	25%	45%	E arritur.

Procesi i përgatitjes së raportit të monitorimit

Ky raport vjetor i zbatimit të Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave (2017-2021) për vitin 2020, përmban të dhëna mbi zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë dhe përmbushjen e indikatorëve për periudhën raportuese. Sa i përket në përgjithësi, struktura e administrimit dhe monitorimit institucional të Reformës së Administratës Publike (PAR) është përcaktuar nga Qeveria me vendim të Qeverisë Nr. 05/09 (datë 21/01/2015) për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave për të siguruar zbatimin e PAR dhe vendimi Nr. 9/13 (datë 12/02/2015) për organizimin dhe funksionimin e strukturave për zbatimin e dokumenteve strategjike të RAP, ku si mekanizmi kryesor mbikëqyrës për zbatimin e PAR është caktuar Këshilli i Ministrave për Reformën në Administratën Publike (KMRAP).

Ndërsa administrimi dhe koordinimi për monitorimin e zbatimit të RAP në nivelin teknik, bëhet nga tri institucione: Zyra e Kryeministrit është përgjegjëse për reformat në lidhje me zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe legjislativitet; Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për shërbimin civil, ofrimin e shërbimeve, përgjegjshmërinë dhe organizimin e Administratës Publike; dhe, Ministria e Financave është përgjegjëse për reformat në lidhje me Menaxhimin e Financave Publike.

Koncepti Dokumenti mbi sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të RAP, përcakton elementet kryesore për monitorimin dhe raportimin në procesin e RAP. Sidoqoftë, vitin e kaluar, formati i raportit u azhurnua në bazë të Udhëzuesit OECD / SIGMA për përgatitjen, zbatimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e PAR-it dhe strategjive sektoriale të harmonizuara, si dhe me UA (GRK) 07/2018 për Planifikimi dhe hartimi i dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit⁵.

⁵AI (GRK) on Planning and Drafting the Strategic Documents and Action Plans http://kryeministri-ks.net/ë_p_content/uploads/2018/04/UDH%C3%8BZIMI-ADMINISTRATIV-QRK-NR.-07-2018-P%C3%8BR-PLANIFIKIMIN-DHE-HARTIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-T%C3%8B-VEPRIMIT-28-03-2018.pdf

SPPKP 2017-2021 ka një plan veprimi të rishikuar që përfshin periudhën 2020-2021, i cili përbëhet nga aktivitete, tregues, institucione përgjegjëse për zbatim dhe kosto financiare për zbatim. Struktura për monitorimin e zbatimit të SPPKP 2017-2019 përbëhet nga indikatorë të matshëm të cilët janë vendosur në nivelin e objektivave specifike në strategji. Plani i Veprimit përmban gjithsej 15 tregues për 11 objektiva specifike. Metodot specifike të përcaktimit dhe matjes janë shtjelluar në "Pasaportën e Treguesit". Përgatitja e raportit bazohet në të dhënat e siguruar nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve nga Plani i Veprimit për periudhën raportuese, dhe të dhënat përpunohen dhe paraqiten në raport nga Zyra e Planifikimit Strategjik në ZKM. Në lidhje me përfshirjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile në përgatitjen e raportit, asnjë përfaqësues i OShC-ve nuk është përfshirë në procesin e raportit të monitorimit.

Monitorimi i progresit të zbatimit dhe arritjeve të strategjisë u komunikohet organeve përkatëse rregullisht dhe sipas nevojës edhe opinionit publik. Përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë është Grupi Drejtues i Planifikimit Strategjik (GDPS) i cili përbëhet nga përfaqësues të lartë të nivelit teknik të ZKM, MF, MPB dhe ME. Monitorimi dhe raportimi është gjithashtu i koordinuar me monitorimin dhe raportimin e Strategjisë për Rregullim më të Mirë pasi që të dy strategjitë janë në kuadrin e planifikimit strategjik të ZKM-së.

Aspekti financiar i zbatimit të Strategjisë

Vlerësimi i përgjithshëm i kostove të aktiviteteve për Planin e Veprimit të rishikuar dy vjeçar (2020-2021) të SPPKP (sistemi i planifikimit të integruar) ka një kosto totale për zbatimin e tij në shumën prej 630,000 Euro, për vitin 2020 të planifikuara janë 350,000 uro ndërsa për vitin 2021 të planifikuara janë 280,000 euro.

Zbatimi i Planit të Veprimit të strategjisë është mbështetur nga donatorët, përmes projekteve ekzistuese që mbë shtesin Qeverinë në fushën e hartimit dhe Planifikimit të Politikave. Një pjesë e koston është e lidhur me koston e tjera brenda buxhetit ekzistues të planifikuar në ZKM dhe Ministrinë që ishin të përfshira në zbatim. Gjithashtu, Projekti i Asistencës Teknike të BE-së "Mbështetje për Zyrën për Planifikim Strategjik" që ka filluar në vitin 2019 dhe do të finalizohet gjatë periudhës 2020-21, do të mbulojë një pjesë të aktiviteteve të Planit të Veprimit edhe nga aspekti financiar, prandaj ekziston sigurimi i mbulimit financiar edhe për Planin e ri të Veprimit 2020-2021.

Zbatimi i përgjithshëm i objektivave të Strategjisë

Ky seksion ofron, informacion empirik mbi objektivat e përgjithshëm dhe objektivat specifike, prezantimin e shkallës së zbatimit të aktiviteteve, shkallën e zbatimit të rezultateve, si dhe sfidat dhe hapat e ardhshëm.

Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike

Ky objektiv fokusohet në harmonizimin dhe ndërlidhjen e të gjitha dokumenteve planifikuese, duke përfshirë edhe dokumentet që derivojnë nga procesi i integritimit evropian, përmes fuqizimit të mekanizmave koordinues dhe institucional dhe vendosjes së një kalendarit të integruar të planifikimit strategjik. Përmirësimi i planifikimit strategjik të politikave sektoriale dhe kombëtare për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së dhe të prioritetëve të tjera, bazuar në një qasje të harmonizuar me kornizën kombëtare, me qëllim të përgatitjes për fazën e ardhshme të aderimit në BE përbënë një fokus tjetër të rëndësishëm. Gjithashtu, fokus tjetër i këtij objekti është konsolidimi i kornizës strategjike sektoriale, përmirësimi i cilësisë së planifikimit sektorial, duke përfshirë kostimin dhe prezantimin e indikatorëve të performancës gjatë procesit të planifikimit.

Objekti i Specifik 1.1 Ndërlidhja e dokumenteve kryesore strategjike me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe sigurimi i zbatimit të saj

Për periudhën raportuese, ky objektiv specifik ka patur të planifikuara 4 aktivitete nga të cilat dy janë të zbatuara pjesërisht dhe dy plotësisht të zbatuara.

Sa i përket përkufizimit të tipologjisë dhe hierarkisë së dokumenteve të planifikimit strategjik në Rregulloren e Punës së Qeverisë (RrPQ) së Kosovës, e cila është në proces sipër, në kuadër të punës që është duke u zhvilluar në Grupin Punues për plotësim/ndryshimin e Rregullores së Punës së Qeverisë, Zyra për Planifikim Strategjik, ka ofruar përkufizimet përkatëse mbi tipologjinë dhe hierarkinë e dokumenteve të planifikimit strategjik, mirëpo dokumenti është ende në fazë draftimi. Nga kjo pastaj është varur edhe plotësim/ndryshimi në UA 07/2018 sipas nevojave për zbatimin e Kornizës për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik dhe harmonizimi me intervenimet e bëra në RrPQ. Ndërsa, Koncepti për Kornizën për Planifikim Strategjik është miratuar në Komisionin për Planifikim Strategjik, i udhëhequr nga Kryeministri, dhe në proces janë reflektimi i kësaj kornize në Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe pas miratimit të saj edhe në UA 07/2018.

Lidhur me aktivitetin për riformulimin e Tabelës A të PPQ me prioritetet që janë të definuara sipas SKZH, Programit të Qeverisë dhe vendosja e referencës përkundrejt objektivave strategjike dhe specifike të SKZH dhe strategjive sektoriale, ZPS vitin e kaluar (2020) është përkujdesur që gjatë përgatitjes së PPQ, më saktësisht Tabelës A, të vendosen prioritetet nga SKZH, Programi i Qeverisë, dhe vendosja e referencës përkundër objektivave strategjike dhe specifike deri në një masë aq sa ka qenë e mundur, por që riformulim të Tabelës A nuk ka patur.

Poashtu, një aktivitet shumë i rëndësishëm ka qenë rishikimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) ekzistuese dhe hartimi i propozimit për SKZH e ardhshme. ZPS me mbështetje të Projektit të BE "Mbështetje për Zyrën për Planifikim Strategjik" ka hartuar konceptin për miratimin e Strategjisë së Re 2030, e cila është miratuar në Qeveri në Korrik 2020. Poashtu, në të njëjtën kohë ka filluar edhe vlerësimi i zbatimit të SKZH të kaluar, më specifikisht shtylla e parë - Kapitali njerëzorë.

Objekti i Specifik 1.2 Përmirësimi i planifikimit strategjik të politikave për përmbushjen e detyrimeve të MSA

Për periudhën raportuese, ky objektiv specifik ka patur të planifikuara dy aktivitete të cilat njëra është zbatuar pjesërisht ndërsa tjetra plotësisht e zbatuar.

Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet PKZMSA dhe PPQ – përmes miratimit të PKZMSA dhe PPQ në të njëjtën kohë (ZKM siguron ndërlidhjen gjatë rishikimit përfundimtar para miratimit në Qeveri). Niveli i përgjithshëm

i harmonizimit të PKZMSA 2020 me PPQ (përfshirë PL) ka qenë 93.75%, mirë po nuk është arritur që miratimi i tyre të bëhet në të njëjtën kohë në Qeveri ashtu siq është planifikuar.

Ndërsa lidhur me themelimin e ekipeve të përbashkëta nga Ministrinë e Linjës dhe QeQ të cilat do të jenë të njëjtat ekipe që punojnë në përgatitjen e PPQ dhe PKZMSA, ekipet e njëjta nga Ministrinë e Linjës dhe QeQ kanë punuar në përgatitjen e PPQ dhe PKZMSA. Niveli i përgjithshëm i harmonizimit të PKZMSA 2020 me PPQ (përfshirë PL) ka qenë 93.75%, pasi që 150 nga 160 masa afatshkurta të planifikuara në PKZMSA për të cilat janë përgjegjëse institucionet e Qeverisë janë pjesë e PPQ-së (përfshirë PL-në), ndërsa 10 (6.25%) prej tyre nuk janë pjesë e tij.

Niveli i harmonizimit të pjesës së legjislacionit kornizë të PKZMSA 2020 me PL (pjesë e PPQ-së) është 100%, pasi që të gjitha (38) projektligjet e planifikuara në PKZMSA janë pjesë e PL-së. Niveli i harmonizimit të pjesës së akteve nënligjore të PKZMSA 2020 me PPQ është 95.56%, pasi që 43 nga 45 projekt-aktet nënligjore të planifikuara në PKZMSA për të cilat janë përgjegjëse institucionet e Qeverisë janë pjesë e PPQ-së, ndërsa 2 (4.44%) prej tyre nuk janë e tij. Ndërsa, niveli i harmonizimit të pjesës së masave zbatuese të PKZMSA 2020 me PPQ është 89.61%, pasi që 69 nga 77 masa zbatuese të planifikuara në PKZMSA për të cilat janë përgjegjëse institucionet e Qeverisë janë pjesë e PPQ-së, ndërsa 8 (10.39%) prej tyre nuk janë pjesë e tij.

Objektivi Specifik 1.3: Konsolidimi i Kornizës së Strategjive Sektoriale.

Për periudhën raportuese, ky objektivi specifik ka patur të planifikuara 2 aktivitete dhe njëri është zbatuar pjesërisht kurse tjetëri është plotësisht i zbatuar.

Lidhur me definimin e sektorëve / fushave të politikave të ndërlidhura me klasifikimin funksional sipas COFOG dhe përfshirja e këtyre definicioneve në UA 07/2018. ZPS, bazuar në Konkretin e Kornizës për Planifikim Strategjik, ka përcaktuar edhe sektorët/apo fushat e politikave, mbi të cilët gjithashtu do të hartohet SKZH 2030 e cila është në harmoni me klasifikimin funksional sipas COFOG, mirëpo, ende nuk ka filluar procesi i rishikimit të UA 07/2018 në mënyrë që të definohen/përcaktohen edhe aty këta sektorë të politikave.

Aktiviteti i dytë ka të bëjë me skanimin e të gjitha dokumenteve strategjike ekzistuese dhe propozimi i sistemit të dokumenteve strategjike për miratim i cili është zbatuar plotësisht. Gjatë vitit 2019, ka filluar të zhvillohet një skanim i tillë i cili ka përfunduar në 2020. Me këtë është arritur të propozohet: konsolidimi i kornizës ekzistuese kombëtare të planifikimit, duke përfshirë vendosjen e hierarkisë së objektivave në dokumente të ndryshme strategjike, dhe duke i synuar ndërlidhjen me dokumentet buxhetore; vendosja e përkufizimeve të sektorëve që do të përdoren për planifikimin strategjik, KASH, etj; identifikimi i strategjive sektoriale që duhet të përmirësohen; sistemi i ri i dokumenteve strategjike i definuar.

Objektivi Specifik 1.4: Përmirësimi i procesit të koordinimit dhe vendimmarrjes në nivel qendror dhe në nivelin e ministrive.

Për periudhën raportuese, ky objektivi specifik ka patur të planifikuara gjithsej 2 aktivitete dhe njëri është zbatuar plotësisht kurse tjetri në zbatim e sipër. Rishikimi i vendimeve për rolin dhe përgjegjësitë e Komisionit për Planifikim Strategjik (KPS) dhe Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS) ka përfunduar, është bërë rishikimi i vendimeve për rolin dhe përgjegjësitë e Komisionit për Planifikim Strategjik (KPS) dhe Grupit Drejtues për Planifikim, dhe është miratuar vendimi për këto struktura në Qeveri. Poashtu është miratuar edhe Udhëzuesi për Punën e këtyre strukturave nga ana e Kryeminsitrit, më datë 13/08/2020.

Ndërsa, aktiviteti që ka të bëjë me përgatitjen e vendimit dhe themelimin e Grupeve për Menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Linjës të udhëhequra nga Ministri, nuk ka patur progres në zbatim, GMS-të ende nuk janë të themeluara dhe të funksionalizuara në të gjitha ML.

Ndërlidhja më e mirë e dokumenteve strategjike dhe burimeve financiare

Ky objektivi synon fuqizimin e ndërlidhjes ndërmjet dokumenteve afatmesme planifikuese të Qeverisë (SKZH, PKZMSA, PRE) me KASH dhe buxhetin vjetor; rritje të ndërlidhjes ndërmjet projekteve për investime publike me prioritetet e SKZH-së dhe strategjitë sektoriale përmes një dialogu dhe procesi konsistent të priorizimit, si pjesë përbërëse e planifikimit të KASH-it/buxhetit vjetor; dhe menaxhim efektiv të ndihmës së jashtme, duke fuqizuar proceset e planifikimit dhe programimit me qëllim të harmonizimit dhe ndërlidhjes të fondeve të jashtme me prioritetet e Qeverisë dhe KASH.

Objektivi Specifik 2.1: Përmirësimi i orientimit strategjik të KASHit/buxhetit.

Për periudhën raportuese, ky objektivi specifik ka patur të planifikuara dy aktivitete dhe asnjëri aktivitet nuk ka filluar së zbatuari.

Hartimi i një udhëzuesi për përgatitjen e Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme dhe përcaktimi i këtij procesi edhe në RrP të Qeverisë, nuk ka patur zbatim. Duke u bazuar nën 46 të Rregullores së Punës së Qeverisë, ZPS ka përgatitur Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme (DPA) të Qeverisë për periudhën 2020-2022, mirëpo nuk është arritur që të hartohet Udhëzuesi për përgatitjen e Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme dhe përcaktimi i këtij procesi edhe në RrP të Qeverisë, meqë RrPQ është në proces të plotësim/ndryshimit.

Poashtu, edhe hartimi i metodologjisë për Planin Institucional (PI) përmes shembujve pilot (3 shembuj) të Organizatave Buxhetore, nuk ka patur progress në zbatimin e këtij aktiviteti, pritet që gjatë 2021 të hartohet kjo metodologji për tu pilotuar pastaj në OB, mirëpo pritet që të përfshihen edhe në RrPQ e cila është në proces rishikimi.

Objektivi Specifik 2.2: Përmirësimi i buxhetimit afatmesëm dhe afatshkurtër, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të MSA-së.

Për periudhën raportuese, ky objektivi specifik ka patur të planifikuara 1 aktivitet dhe nuk ka filluar zbatimin. Kjo ka të bëjë me aplikimin e kostimit të masave afatmesme të PKMZSA-së pilotuar në 2-3 ministri ose fusha sektoriale, nuk ka patur zbatim, edhe pse drafti final i PKMZSA 2021-25 i ka gjithsej 302 masa afatshkurtëran dhe të gjitha, 100% janë të buxhetuara, prej të cilave 18 me kosto administrative dhe 284 me kosto specifike buxhetore nga buxheti i 2021 dhe burimet e ndihmës së jashtme. Ky draft mund të pësojë ndryshime pasi Qeveria e re ka marrë detyrën, sepse duhet të harmonizohet me Programin e Qeverisë së re.

Objektivi Specifik 2.3: Menaxhimi efektiv i ndihmës së jashtme

Për periudhën raportuese, ky objektivi specifik ka patur të planifikuara gjithsej 1 aktivitet i cili është pjesërisht i zbatuar. Përgatitja e raportit vjetor për projektet të financuara nga donatorët e AJ-së (duke theksuar rezultatet e arritura kundrejt atyre të pritshme dhe kontributet e asistencës së jashtme) nuk është përfunduar. Gjatë vitit 2020 nuk janë mbajtur grupet punuese sektoriale dhe nën-sektoriale për koordinimin me donatorët, grupe këto që shërbejnë si platformë për koordinim, planifikim dhe harmonizim të ndihmës së jashtme me prioritetet vendore.

Ndërsa, gjatë 2020, raporti vjetor për aktivitetet e donatorëve për vitin 2019, është përfunduar. Ky raport ofron një pasqyrë të qartë për projektet e donatorëve që janë zbatuar gjatë vitit 2019, përfshi këtu zotimet dhe shpenzimet sipas donatorëve, sektorëve të OECD-së dhe modalitetit të ndihmës. Mirëpo, nuk ofron informata më të hollësishme se cilat kanë qenë sfidat gjatë zbatimit të këtyre projekteve, sa kanë qenë të harmonizuara/ndërlidhura me prioritetet sektoriale, sa ka qenë shkalla e duplikimit të komponenteve të projekteve të donatorëve të përfshirë brenda një sektori të caktuar.

Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit

Qëllimi kryesor i objektivit është përmirësimi i sistemit të monitorimit të dokumenteve kryesore të planifikimit, duke përfshirë vendosjen e një procesi sistematik të monitorimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale. Gjithashtu, ky objektivi ka për synim vendosjen e një Sistemi të Integruar të Monitorimit përmes Planit Vjetor të Punës së Qeverisë, me qëllim që të sigurojë për Qeverinë informacionin e nevojshëm në lidhje me monitorimin për të përcjellë zotimet kryesore të saj (duke përfshirë po ashtu të gjitha iniciativat e dakorduara të integrimit evropian, ku synohet të avancohet dhe integrohet edhe sistemi i monitorimit dhe raportimit të PKZMSA-së.); dhe t'i sigurojë Qeverisë, institucioneve të Qendrës së Qeverisë, si dhe menaxhmentit të lartë të ministrive informacion të plotë mbi realizimin e planeve operative të ministrive.

Objekivi Specifik 3.1: Përmirësimi i monitorimit të strategjive sektoriale duke përfshirë vlerësimin periodik të tyre.

Për periudhën raportuese, ky objektivi specifik ka patur të planifikuara katër aktivitete dhe tri nuk janë zbatuar fare kurse një aktivitet është në zbatim e sipër.

Sa i përket mbështetjes për Ministrinë e Linjës për hartimin e raporteve vjetore të monitorimit për zbatimin e strategjive të sektorit, nuk ka patur progres në zbatimin e këtij aktiviteti. Me UA 07/2018 të rishikuar, Ministrinë janë të obliguara të përgatisin raporte për zbatimin e strategjive sektoriale si dhe ti publikojnë ato në ueb site të tyre. Për këtë qëllim, ZPS ka planifikuar të mbështes përmes trajnimeve ML-të për përgatitjen e raporteve vjetore për monitorimin e strategjive sektoriale mirëpo për arsye të pandemisë Covid 19 nuk janë realizuar, mbeten të realizohen gjatë 2021.

Përcaktimi i kërkesave të përgjithshme të raportimit për dokumentet e planifikimit qendror në RrPQ- është në zbatim e sipër, por mbetet të finalizohet me miratimin e RrPQ të re që është në proces të plotësim/ndryshimit. RrPQ do të përcaktoj kërkesat e përgjithshme të raportimit për dokumentet e planifikimit qendror. Poashtu, ngjashëm kemi edhe gjendjen me dizajnimin e formatit dhe aplikimin e monitorimi të zbatimit të PPQ të jetë kanal i vetëm monitorimi për të gjithë dokumentet e planifikimit strategjik, nuk ka patur zbatim. Ky aktivitet mbetet të realizohet pas përfundimit të rishikimit të RrPQ ku do të përcaktohet edhe monitorimi i PPQ.

Hartimi i konceptit për krijimin e një faqe interneti qendrore për publikimin e dokumenteve të politikave, përfshirë raportet për zbatimin e tyre, nuk ka patur zbatim. Ky aktivitet mbetet të realizohet pas përfundimit të rishikimit të RrPQ ku vendosen përfundimisht format e monitorimit dhe raportimit të dokumenteve të politikave si dhe publikimi i këtyre raporteve. Ky aktivitet ka si produkt konceptin e finalizuar për një uebfaqe qendrore për publikimin e dokumenteve të politikave (përfshirë raportet e strategjive sektoriale).

Objekivi Specifik 3.2: Fuqizimi i rolit të sistemit të monitorimit të PVPQ-së si mekanizëm për informim të politikëbërësve dhe rritjes së llogaridhënies të ML.

Për periudhën raportuese, ky objektivi specifik ka patur të planifikuara dy aktivitete dhe njëri aktivitet nuk është zbatuar fare dhe tjetri pjesërisht i zbatuar.

Harmonizimi i përdorimit të treguesve të performancës në nivel rezultati në Planin e Punës së Qeverisë me SKZH, PRE dhe treguesit e tjerë të strategjive sektoriale, ky aktivitet nuk ka patur zbatim, PPQ përmban indikatorë të rezultatit por që nuk janë të harmonizuar plotësisht me SKZH, PRE dhe strategji të tjera sektoriale. Kjo pritet që të rregullohet me hartimin e SKZH 2030 e cila do të përmbajë indikatorët kryesorë për të gjithë sektorët e politikave të cilët do të përdoren poashtu edhe për nevoja të PPQ – për monitorimin dhe raportimin e saj.

Mbikëqyrja dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të PKZMSA-së, përmes strukturave të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit dhe forcimin e strukturave kombëtare të koordinimit për Integrimin Evropian si një

mekanizëm llogaridhënës, pjesërisht me zhvillime. Mbikqyrja dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të PKZMSA është bërë përmes strukturave përgjegjëse, dhe nga ky monitorim del se shkalla e zotimeve të përgjithshme të bartura në vitin 2021 është 42.56%. Kjo i bie që nga 195 masa afatshkurtra të parashikuara në kuadër të PKZMSA 2020-24, 83 prej sosh janë bartur si masa afatshkurtra në draftin e PKZMSA 2021-25. Ky cak është rreth 32% larg cakt të synuar përfundimtarë për vitin 2021.

Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.

Përmes këtij objekti strategjik synohet të arrihet ndërtimi dhe ngritja e kapaciteteve për proceset e ndryshme të sistemit të planifikimit të integruar, duke u bazuar në intervenimet ekzistuese dhe të planifikuara të institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gjithashtu, theks i veçantë do të vihet në ngritjen e kapaciteteve për fuqizimin e koordinimit dhe strukturave vendimmarrëse, zhvillimin e politikave në kontekst të integritit evropian dhe menaxhimit të ndihmës së jashtme.

Objekti specifik 4.1: Plotësimi me personelin e nevojshëm për planifikimin dhe koordinimin e politikave

Kjo objektivi specifikë tanimë është përbushur në vitin 2019, me rekrutimin e 10 bursistëve të rinj në ZKM.

Objekti Specifik 4.2: Ndërtimi i kapaciteteve për planifikimin dhe koordinimin e politikave

Për periudhën raportuese, kjo objektivi specifikë ka patur të planifikuara pesë aktivitete dhe tri aktivitete janë zbatuar plotësisht ndërsa dy nuk kanë filluar së zbatuari. Në vazhdim janë të prezantuara aktivitetet e planifikuara dhe niveli i zbatimit të tyre.

- Rishikimi i moduleve ekzistuese të trajnimit për Planifikimin Strategjik dhe trajnimin e trajnerëve bazuar në kurrikulën e re të zhvillimit të strategjive është zbatuar plotësisht. Gjatë vitit 2020 janë realizuar 9 ditë trajnimi, të ndarë në 3 grupe nga 3 ditë për trajnimin "Hartimi i strategjive, monitorimi dhe vlerësimi i tyre", trajnimin e kanë vijuar 18 pjesëmarrës.
- Trajnimi i anëtarëve të grupeve të punës të përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike sipas viteve përkatëse, nuk ka patur zbatim. Për shkak të pandemisë Covid 19, trajnimet e parpara me anëtarë të grupeve punuese të përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike nuk janë mbajtur siq janë planifikuar, edhe pse mbështetje e vazhdueshme iu është dhënë sipas nevojës nga ana e ZPS.
- Trajnimi i stafit të ministrive për përgatitjen e Programit të Reformës Ekonomike, zhvillimin e treguesve të performancës dhe koston e masave strukturore, nuk ka patur zbatim. Për shkak të pandemisë Covid 19, trajnimet e parpara me anëtarë të grupeve punuese të përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike nuk janë mbajtur siq janë planifikuar, edhe pse mbështetje e vazhdueshme iu është dhënë sipas nevojës nga ana e ZPS të gjitha ministrive gjatë procesit të hartimit të PRE.
- Organizimi dhe sigurimi i trajnimeve për zbatimin e MSA-së, është zbatuar plotësisht. Gjatë vitit 2020, për çështjet integritit evropian dhe të zbatimit të MSA janë organizuar tritrajnime për aspektet e përgjithshme në temat "Procesi dhe teknikat për informimin e publikut mbi detyrimet që rrjedhin nga MSA" dhe "Njohuri për procesin e negociatave me BE-në për marrjen e statusit të vendit kandidat". Në trajnimet e mbajtura janë trajnuar 135 pjesëmarrës në 26 ditë trajnim. Gjatë 2020 janë organizuar edhe tre trajnime për aspektet standardeve për kapitujt "Lëvizja e lire e mallrave", "E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve" dhe për Kapitullin 23-"Gjyqësori dhe të drejtat themelore". Në trajnimet e mbajtura janë trajnuar 51 pjesëmarrës në 22 ditë trajnim.

- Organizimi dhe sigurimi i trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve të administratës për menaxhimin e ndihmës së jashtme, si pjesë e rregullt e programeve të siguruar nga IKAP, janë zbatuar sipas planifikimit. Në zbatim të menaxhimit të ndihmës së jashtme është organizuar pakoja prej katër moduleve të trajnimit: Instrumenti i para anëtarësimit, Koordinimi dhe monitorimi i programeve të donatorëve me fokus programet e BE-se; - Përgatitja e projekt propozimeve; dhe - Cikli i menaxhimit të projekteve. Në trajnimet e mbajtura janë trajnuar 23 pjesëmarrës në 7 ditë trajnim. IKAP është në proces të hartimit të planit afatgjatë të trajnimit për gjatë vitit 2021 do të vijoj mbajtjen e trajnimeve për menaxhimin të ndihmës së jashtme.

Sfidat dhe rekomandimet

Ky seksion nënvizon sfidat kryesore për periudhën raportuese si dhe hapat e ardhshëm në trajtimin e sfidave të identikuara.

Tabela 3: Sfidat dhe hapat e ardhshëm

Sfidat	Hapat e ardhshëm/rekomandimet
Ndërlidhja dhe harmonizimi i dokumenteve kryesore të planifikimit strategjik mbetet një sfidë.	Kjo pritet të përmirësohet me rishikimin e SKZH që planifikohet të filloj gjatë 2020, ku do të përfshihen prioritetet strategjike për më shumë sektorë, meqë SKZH aktuale nuk përfshinë të gjithë sektorët e politikave andaj edhe ndërlidhja është e ulët me PPQ, PKZMSA dhe KASH.
Sfidë tjetër mbetet edhe funksionalizimi strukturave për vendimmarrje dhe planifikim strategjik siq janë KPS, GDPS dhe GMS-të.	Kjo pritet të përmirësohet me rregullimin e funksioneve të tyre, edhe brenda Rregullores së Punes së Qeverisë, e cila është nën procesin e ndryshimit.
Përqindja e ndërlidhjes së Projekteve nga Lista Prioritare e Projekteve me prioritetet e SKZH-së.	Për të adresuar këto sfida, duhet të sigurohet një harmonizim më i mirë me prioritetet brenda Strategjisë së reformës MFP, si dhe të prezantohen aktivitetet të reja që do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të kërkuara, të cilat pritet të adresohen me hartimin e Strategjisë së re për Menaxhimin e Financave Publike që do të filloj gjatë 2021 por edhe me hartimin e SKZH 2030.
Programi për Asistencën Zhvillimore dhe i ndërlidhur me KASH.	
Vendosja në funksion e kalendarit të Sistemit për Planifikim të Integruar.	
Raporti ndërmjet fondeve të përgjithshme të vlerësuar në strategjitë sektoriale dhe financimit të përgjithshëm të identifikuar për sektorët përkatës në KASH.	
Rritja e numrit të strategjive sektoriale që kanë hartuar dhe publikuar raporte vjetore.	Mbeshtetje për ministrinë e linjes në proces të hartimit të këtyre raporteve, dhe inkurajimi i institucioneve për publikim e raporteve, kjo pritet të rregullohet me kërkesat e reja që do të vendosen në RrPQ.
Prezantimi dhe futja në zbatim të ndryshimeve për planifikimin dhe koordinimin strategjik të zyrarët në qeverinë qendrore dhe ministrinë e linjës.	Mjetet dhe metodologjitë për planifikimin dhe koordinimin strategjik vazhdimisht janë duke u avancuar, prandaj mbetet sfida për të prezantuar këto ndryshime tek zyrarët në Qendrën e Qeverisë dhe ministrinë e linjës. Përveç nevojës për ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve, duhet të rritet numri i stafit në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i dispozitave të UA dhe rregulloreve të tjera.

Shtojca 1. Tabela me zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit për vitin 2020

TABELA E ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE TË REFORMËS PËR 2020					
Objektivi strategjik #1:		Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, duke përmirësuar ndërlidhjen e dokumenteve strategjike, përmes koordinimit dhe vendimmarrjes më të mirë			
Objektivi Specifik 1.1		Ndërlidhja e dokumenteve kryesore strategjike me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe sigurimi i zbatimit të saj			
Nr.	Aktiviteti	Statusi	Institucioni përgjegjës	Përshkrim i shkurtër i progresit	Produkti final i aktivitetit
1.1.1	Përkufizimi i tipologjisë dhe hierarkisë së dokumenteve të planifikimit strategjik në Rregulloren e Punës së Qeverisë (RrPQ) së Kosovës.	Nuk është zbatuar.	ZKM (ZPS)	Në kuadër të punës që është duke u zhvilluar në Grupin Punues për plotësim/ndryshimin e Rregullores së Punës së Qeverisë, Zyra për Planifikim Strategjik, ka ofruar përkufizimet përkatëse mbi tipologjinë dhe hierarkinë e dokumenteve të planifikimit strategjik, mirëpo dokumenti është ende në fazë draftimi.	Rregullorja e Punës së Qeverisë me plotësim/ndryshimet e miratuara.
1.1.2	Plotësim/ndryshimi në UA 07/2018 sipas nevojave për zbatimin e Kornizës për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik dhe harmonizimi me intervenimet e bëra në RrPQ.	Nuk është zbatuar.	ZKM (ZPS)	Koncepti për Kornizën e Planifikimit Strategjik është miratuar në Komisionin për Planifikim Strategjik, i udhëhequr nga Kryeministri, dhe në proces janë reflektimi i këtyre në Rregulloren e Punës së Qeverisë e cila është duke u rishikuar, dhe pas miratimit të saj edhe në UA 07/2018.	UA 07/2018 e plotësuar dhe e miratuar me qëllim të zbatimit të KPMS.
1.1.3	Riformulimi i Tabelës A të PPQ me prioritetet që janë të definuara sipas SKZH, Programit të Qeverisë dhe vendosja e referencës përkundër objektivave strategjike dhe specifike të SKZH dhe strategjive sektoriale.	Plotësisht e zbatuar.	ZKM (ZPS)	ZPS vitin e kaluar (2020) është përkujdesur që gjatë përgatitjes së PPQ, më saktësisht Tabelën A, të vendosen prioritetet nga SKZH, Programi i Qeverisë, dhe vendosja e referencës përkundër objektivave strategjike dhe specifike deri në një masë aq sa ka qenë e mundur, por që riformulim të Tabelës A nuk ka patur.	Tabela A e PPQ përmban prioritetet që dalin nga Programi i Qeverisë, SKZH dhe strategjitë sektoriale.
1.1.4	Rishikimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) ekzistuese dhe hartimi i propozimit për SKZH e ardhshme.	Pjesërisht e zbatuar.	ZKM (ZPS)	ZPS me mbështetje të Projektit të BE "Mbështetje për Zyrën për Planifikim Strategjik" ka hartuar konceptin për miratimin e Strategjisë së Re 2030, e cila është miratuar në Qeveri në Korrik 2020. Poashtu, në të njëjtën kohë ka filluar edhe vlerësimin e zbatimit të SKZH të kaluar, më	Propozimi për SKZH-në e ardhshme.

				specifikisht shtylla e parë - Kapitali njerëzorë .	
Objektivi Specifik 1.2		Përmirësimi i planifikimit strategjik të politikave për përmbushjen e detyrimeve të MSA			
No	Aktiviteti	Statusi	Institucioni përgjegjës	Përshkrim i shkurtër i progresit	Produkti final i aktivitetit
1.2.1	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet PKZMSA dhe PPQ – përmes miratimit të PKZMSA dhe PPQ në të njëjtën kohë (ZKM siguron ndërlidhjen gjatë rishikimit përfundimtar para miratimit në Qeveri).	Nuk është zbatuar.	ZKM (ZKPSA)	Niveli i përgjithshëm i harmonizimit të PKZMSA 2020 me PPQ (përfshirë PL) ka qenë 93.75%, mirë po nuk është arritur që miratimi i tyre të bëhet në të njëjtën kohë në Qeveri.	PPQ përmban masat afatshkurtëra të PKZMSA.
1.2.2	Themelimi i ekipeve të përbashkëta nga Ministrinë e Linjës dhe QeQ të cilat do të jenë të njëjtat ekipe që punojnë në përgatitjen e PPQ dhe PKZMSA.	Plotësisht e zbatuar.	ZKM (ZKPSA)	<p>Ekipeve të njëjta nga Ministrinë e Linjës dhe QeQ kanë punuar në përgatitjen e PPQ dhe PKZMSA.</p> <p>Niveli i përgjithshëm i harmonizimit të PKZMSA 2020 me PPQ (përfshirë PL) ka qenë 93.75%, pasi që 150 nga 160 masa afatshkurta të planifikuara në PKZMSA për të cilat janë përgjegjëse institucionet e Qeverisë janë pjesë e PPQ-së (përfshirë PL-në), ndërsa 10 (6.25%) prej tyre nuk janë pjesë e tij.</p> <p>Niveli i harmonizimit të pjesës së legjislacionit kornizë të PKZMSA 2020 me PL (pjesë e PPQ-së) është 100%, pasi që të gjitha (38) projektligjet e planifikuara në PKZMSA janë pjesë e PL-së.</p> <p>Niveli i harmonizimit të pjesës së akteve nënligjore të PKZMSA 2020 me PPQ është 95.56%, pasi që 43 nga 45 projekt-aktet nënligjore të planifikuara në PKZMSA për të cilat janë përgjegjëse institucionet e Qeverisë janë pjesë e PPQ-së, ndërsa 2 (4.44%) prej tyre nuk janë e tij.</p> <p>Niveli i harmonizimit të pjesës së masave zbatuese të PKZMSA</p>	Ekipeve të njëjta të përbëra nga përfaqësues të ML dhe QeQ hartojnë PPQ dhe PKZMSA.

				2020 me PPQ është 89.61%, pasi që 69 nga 77 masa zbatuese të planifikuara në PKZMSA për të cilat janë përgjegjëse institucionet e Qeverisë janë pjesë e PPQ-së, ndërsa 8 (10.39%) prej tyre nuk janë pjesë e tij.	
Objektivi Specifik 1.3:		Konsolidimi i Kornizës së Strategjive Sektoriale.			
Nr.	Aktiviteti	Statusi	Institucioni përgjegjës	Pershkrim i shkurtër i progresit	Produkti final i aktivitetit
1.3.1	Definimi i sektorëve / fushave të politikave të ndërlidhura me klasifikimin funksional sipas COFOG dhe përfshirja e këtyre definicioneve në UA 07/2018.	Nuk është zbatuar.	ZKM(ZPS)	ZPS, bazuar në Konceptin e Kornizës për Planifikim Strategjik, ka vendosur edhe sektorë t/apo fushat e politikave, mbi të cilët gjithashtu do të hartohet SKZH 2030 e cila është në harmoni me klasifikimin funksional sipas COFOG, mirë po, ende nuk ka filluar procesi i rishikimit të UA 07/2018 në mënyrë që të definohen/përcaktohen edhe aty këta sektorë të politikave.	UA 07/2018 me plotësim ndryshimet përcaktojnë definimin e sektorëve.
1.3.2	Skanimi i të gjitha dokumenteve strategjike ekzistuese dhe propozimi i sistemit të dokumenteve strategjike për miratim.	Plotësisht e zbatuar.	ZKM (ZPS)	Gjatë vitit 2019, ka filluar të zhvillohet një skanim i tillë i cili ka përfunduar në 2020. Me këtë është arritur të propozohet: a)Konsolidimi i kornizës ekzistuese kombëtare të planifikimit, duke përfshirë vendosjen e hierarkisë së objektivave në dokumente të ndryshme strategjike, dhe duke i synuar ndërlidhjen me dokumentet buxhetore; b) Vendosja e përkufizimeve të sektorëve që do të përdoren për planifikimin strategjik, KASH, etj; c) Identifikimi i strategjive sektoriale që duhet të përmirësohen;	Sistemi i ri i dokumenteve strategjike i definuar dhe konsoliduar.
Objektivi Specifik 1.4:		Përmirësimi i procesit të koordinimit dhe vendimmarrjes në nivel qendror dhe në nivelin e ministrive.			
1.4.1	Rishikimi i vendimeve për rolin dhe përgjegjësitë e Komisionit për	Plotësisht e zbatuar.	ZKM (ZPS)	Është bërë rishikimi i vendimeve për rolin dhe përgjegjësitë e Komisionit për Planifikim Strategjik (KPS) dhe Grupit	Vendimet e rishikuara dhe të miratuara nga

	Planifikim Strategjik (KPS) dhe Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS).			Drejtues për Planifikim, dhe është miratuar vendimi për këto struktura në Qeveri. Poashtu është miratuar edhe Udhëzuesi për Punën e këtyre strukturave nga ana e Kryeminsitrit, më datë 13/08/2020.	Qeveria për KPS dhe GDPS.
1.4.2	Përgatitja e vendimit dhe themelimi i Grupeve për Menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Linjës të udhëhequra nga Ministri.	Nuk ka patur zbatim.	ZKM (ZPS)	Ky aktivitet nuk ka patur progress në zbatim.	GMS-të të themeluara dhe të funksionalizuara në të gjitha ML.
Objektivi Strategjik #2:		Ndërlidhja më e mirë e kornizës për planifikim strategjik me planifikimin e resurseve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përbalueshmërinë financiare dhe zbatimin e planeve strategjike.			
Objektivi Specifik 2.1:		Përmirësimi i orientimit strategjik të KASHit/buxhetit.			
Nr.	Aktiviteti	Statusi	Institucioni përgjegjës	Pershkrim i shkurtër i progresit	Produkti final i aktivitetit
2.1.1	Hartimi i një udhëzuesi për përgatitjen e Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme dhe përcaktimi i këtij procesi edhe në RrP të Qeverisë.	Nuk ka patur zbatim.	ZKM (ZPS)	Duke u bazuar nën 46 të Rregullores së Punës së Qeverisë, ZPS ka përgatitur Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme (DPA) të Qeverisë për periudhën 2020-2022, mirë po nuk është arritur që të hartohet udhëzuesi për përgatitjen e Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme dhe përcaktimi i këtij procesi edhe në RrP të Qeverisë, meqë RrPQë shtë në proces të plotë sim /ndryshimit.	Ndryshimet në RrPQ të miratuara.
2.1.2	Hartimi i metodologjisë për Planin Institucional (PI) përmes shembujve pilot (3 shembuj) të Organizatave Buxhetore.	Nuk ka patur zbatim.	ZKM(ZPS)	Nuk ka patur progress në zbatimin e këtij aktiviteti, pritet që gjatë 2021 të hartohen kjo metodologji për tu pilotuar pastaj në OB, mirë po pritet që të përfshihen edhe në RrPQ e cila është në proces rishikimi.	IP të hartuar pilotohen për 3 Organizata Buxhetore.
Objektivi Specifik 2.2:		Përmirësimi i buxhetimit afatmesëm dhe afatshkurtër, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të MSA-së.			
Nr.	Aktiviteti	Statusi	Institucioni përgjegjës	Pershkrim i shkurtër i progresit	Produkti final i aktivitetit
2.2.1	Aplikimi i kostimit të masave afatmesme të PKMZSA-së pilotuar në 2-3 ministri ose fusha sektoriale.	Nuk ka patur zbatim.	ZKM(ZKPSA)	Drafti final i PKZMSA 2021-25 I ka gjithsej 302 masa afatshkurtë ra. Të gjitha, 100% janë të buxhetuara, prej të cilave 18 me kosto administrative dhe 284 me kosto specifike buxhetore nga buxheti i 2021 dhe burimet e	Kostoja e masave afatmesme të PKZMSA të pilotuara në 2-3 ministri ose fusha sektoriale.

				ndihmë s së jashtme. Ky draft mund të pësoj ndryshime pasi qeveria e re ka marre detyren, sepse duhet te harmonizohet me Programin e Qeverisë së re.	
Objektivi Specifik 2.3:		Menaxhimi efektiv i ndihmës së jashtme			
Nr.	Aktiviteti	Statusi	Institucioni përgjegjës	Pershkrim i shkurter i progresit	Produkti final i aktivitetit
2.3.2	Përgatitja e raportit vjetor për projektet të financuara nga donatorët e AJ-së (duke theksuar rezultatet e arritura kundrejt atyre të pritshme dhe kontributet e asistencës së jashtme).	Nuk është zbatuar.	ZKM (ZBZH)	Gjatë vitit 2020 nuk janë mbajtur grupet punuese sektoriale dhe nën-sektoriale për koordinimin me donatorë, grupe këto që shërbejnë si platformë për koordinim, planifikim dhe harmonizim të ndihmës së jashtme me prioritetet vendore. Ndërsa, raporti vjetor për aktivitetet e donatorëve për vitin 2019, është përfunduar. Ky raport ofron një pasqyrë të qartë për projektet e donatorëve që janë zbatuar gjatë vitit 2019, përfshi këtu zotimet dhe shpenzimet sipas donatorëve, sektorëve të OECD-së dhe modalitetit të ndihmës. Mirëpo, nuk ofron informata më të hollësishme se cilat kanë qenë sfidat gjatë zbatimit të këtyre projekteve, sa kanë qenë të harmonizuara/ndërlidhura me prioritetet sektoriale, sa ka qenë shkalla e duplikimit të komponenteve të projekteve të donatorëve të përfshirë brenda një sektori të caktuar etj.	Raporti vjetor për përfitimet nga asistenca e jashtme.
Objektivi Strategjik #3:		Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit për të siguruar rezultate më të mira të zbatimit dhe llogaridhënies për përmbushjen e objektivave të vendosura të Qeverisë.			
Objektivi Specifik 3.1:		Përmirësimi i monitorimit të strategjive sektoriale duke përfshirë vlerësimin periodik të tyre.			
Nr.	Aktiviteti	Statusi	Institucioni përgjegjës	Pershkrim i shkurter i progresit	Produkti final i aktivitetit
3.1.1	Mbështetje për Ministrinë e Linjës për hartimin e raporteve vjetore të monitorimit për zbatimin e strategjive të sektorit..	Nuk ka patur zbatim.	ZKM(ZPS)	Me UA 07/2018 të rishikuar, Ministrinë janë të obliguara të përgatisin Raporte për zbatimin e strategjive sektoriale si dhe ti publikojnë ato në të dyja site të tyre. Për këto që llim, ZPS ka planifikuar të mbështesë përmes trajnimeve ML-të për përgatitjen e raporteve vjetore për	Të paktën 20 punëtorë të përbashkëta (10 në vit) me ML për përgatitjen e raporteve vjetore të monitorimit të strategjive sektoriale.

				monitorimin e strategjive sektoriale mirë po për arsye të pandemisë Covid nuk janë realizuar, mbeten të realizohen gjatë 2021.	
3.1.2	Përcaktimi i kërkesave të përgjithshme të raportimit për dokumentet e planifikimit qendror në RRP.	Nuk është zbatuar.	ZKM(ZPS)	Ky aktivitet është në zbatim e sipër, por mbetet të finalizohet me miratimin e RrPQ të re që është në proces të plotë sim/ndryshimit.	RrPQ përcakton kërkesat e përgjithshme të raportimit për dokumentet e planifikimit qendror.
3.1.3	Dizajnimi i formatit dhe aplikimi i monitorimi të zbatimit të PPQ të jetë kanal i vetëm monitorimi për të gjithë dokumentet e planifikimit strategjik.	Nuk ka patur zbatim.	ZKM(ZPS)	Ky aktivitet mbetet të realizohet pas përfundimit të rishikimit të RrPQ ku do të përcaktohet edhe monitorimi i PPQ.	PPQ do të jetë një kanal i vetëm monitorimi për të gjithë dokumentet e planifikimit strategjik.
3.1.4	Hartimi i konceptit për krijimin e një faqe interneti qendrore për publikimin e dokumenteve të politikave, përfshirë raportet për zbatimin e tyre.	Nuk ka patur zbatim.	ZKM(ZPS)	Ky aktivitet mbetet të realizohet pas përfundimit të rishikimit të RrPQ ku vendosen përfundimisht format e monitorimit dhe raportimit të dokumenteve të politikave si dhe publikimi i këtyre raporteve.	Koncepti i finalizuar për një uebfaqe qendrore për publikimin e dokumenteve të politikave (përfshirë raportet e strategjive sektoriale).
Objektivi Specifik 3.2:		Fuqizimi i rolit të sistemit të monitorimit të VPQ-së si mekanizëm për informim të politikëbërësve dhe rritjes së llogaridhënies të ML.			
Nr.	Aktiviteti	Statusi	Institucioni përgjegjës	Pershkrim i shkurtër i progresit	Produkti final i aktivitetit
3.2.4	Harmonizimi i përdorimit të treguesve të performancës në nivel rezultati në Planin e Punës së Qeverisë me SKZH, PRE dhe treguesit e tjerë të strategjive sektoriale.	Nuk ka patur zbatim.	ZKM (ZPS, SKQ)	Ky aktivitet nuk është zbatuar, PPQ për rmban indikatorë të rezultatit por që nuk janë të harmonizuar plotësisht me SKZH, PRE dhe Startegji të tjera sektoriale.	Përdorimi i indikatorëve të performancës në nivel rezultati në Planin e Punës së Qeverisë së dhe raportet e tij vjetore të monitorimit.
3.2.5	Mbikëqyrja dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të PKZMSA-së, përfshirë (sipas nevojës) përmes strukturave të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe	Nuk është zbatuar.	ZKM (ZKPSA)	Mbikëqyrja dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të PKZMSA është bërë përmes strukturave përgjegjëse, dhe nga ky monitorim del se shkalla e zotimeve të përgjithshme të bartura në vitin 2021 është	Udhëzime dhe këshilla për ML-të në zbatimin e PKZMSA-së. Raporte të rregullta

	forcimin e strukturave kombëtare të koordinimit për Integrimin Evropian si një mekanizëm llogaridhënës.			42.56%. Kjo i bie që nga 195 masa afatshkurtra të parashikuara në kuadër të PKZMSA 2020-24, 83 prej sosh janë bartur si masa afatshkurtra në draftin e PKZMSA 2021-25. Ky cak ë shtë rreth 32% larg cakt të synuar për rfundimtarë për vitin 2021.	tremujore për zbatimin e PKZMSA-së;
Objektivi Strategjik #4:		Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.			
Objektivi Specifik 4.2:		Zhvillimi i kapaciteteve për planifikimin dhe koordinimin e politikave.			
Nr.	Aktiviteti	Statusi	Institucioni përgjegjës	Pershkrim i shkurter i progresit	Produkti final i aktivitetit
4.2.1	Rishikimi i moduleve ekzistuese të trajnimit për Planifikimin Strategjik dhe trainimin e trajnerëve bazuar në kurrikulën e re të zhvillimit të strategjisë.	Plotësisht e zbatuar.	ZKM (ZPS), IKAP	Gjatë vitit 2020 janë realizuar 9 dite trajnimi, të ndara në 3 grupe nga 3 dite për trajnimin " Hartimi i strategjive, monitorimi dhe vlerësimi i tyre". Trajnimi e kanë vijuar 18 pjesëmarrës dhe 54 pjesëmarrje. IKAP është në proces të hartimit të planit afatgjatë të trajnimit për gjatë vitit 2021 do të vijoj mbajtjen e trajnimeve për udhëzimin e ri për hartimin e strategjive të trajnimit	15 trajnerët janë pranuar në bazë të modulit të modifikuar..
4.2.2	Trajnimi i anëtarëve të grupeve të punës të përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike sipas viteve përkatëse.	Nuk ka patur zbatim.	ZKM (ZPS)	Për shkak të pandemisë Covid 19, trajnimet e parpara me anëtarët e grupeve punuese të përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike nuk janë mbajtur siq janë planifikuar, edhe pse mbështetje e vazhdueshme iu është dhënë në sipas nevojës nga ana e ZPS.	100 anëtarët e grupeve të punës të dokumenteve strategjike janë trajnuar deri në 2021 (50 anëtarë të GP të trajnuar në 2020 + 50 anëtarë të GPK).
4.2.3	Trajnimi i stafit të ministrive për përgatitjen e Programit të Reformës Ekonomike, zhvillimin e treguesve të performancës dhe koston e masave strukturore.	Nuk ka patur zbatim.	ZKM (ZPS)	Për shkak të pandemisë Covid 19, trajnimet e parpara me anëtarët e grupeve punuese të përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike nuk janë mbajtur siq janë planifikuar, edhe pse mbështetje e vazhdueshme iu është dhënë në sipas nevojës nga ana e ZPS.	100 shërbyes civilë (4 x25 pjesëmarrës, nga 50 në vit).
4.2.4	Organizimi dhe sigurimi i trajnimeve për zbatimin e MSA-së.	Plotësisht e zbatuar.	ZKM, IKAP	Gjatë vitit 2020, për çështjet integritetit evropian dhe të zbatimit të MSA janë organizuar	100 zyrtarë të trajnuar.

				<p>tre kurse për aspektet e përgjithshme në temat Procesi dhe teknikat për informimin e publikut mbi detyrimet që rrjedhin nga MSA dhe Njohuri për procesin e negociatave me BE-në për marrjen e statusit të vendit kandidat. Në kurset e mbajtura janë trajnuar 135 pjesëmarrës në 26 ditë trajnim.</p> <p>Gjatë 2020 janë organizuar edhe tre kurse për aspektet standardëve për kapitujt Lëvizja e lire e mallrave, E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve dhe për Kapitullin 23-Gjyqësori dhe të drejtat themelore. Në kurset e mbajtura janë trajnuar 51 pjesëmarrës në 22 ditë trajnim.</p>	
4.2.5	<p>Organizimi dhe sigurimi i trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve të administratës për menaxhimin e ndihmës së jashtme, si pjesë e rregullt e programeve të siguruara nga IKAP.</p>	Plotësisht e zbatuar.	ZKM, IKAP	<p>Në zbatim të menaxhimit të ndihmës së jashtme është organizuar pakoja prej katër moduleve të trajnimit: - Instrumenti i para anëtarësimit, - Koordinimi dhe monitorimi i programeve të donatorëve me fokus programet e BE-se; - Përgatitja e projektpropozimeve; dhe - Cikli i menaxhimit të projekteve.</p> <p>Në kurset e mbajtura janë trajnuar 23 pjesëmarrës në 7 ditë trajnim. IKAP është në proces të hartimit të planit afatgjatë të trajnimit për gjatë vitit 2021 do të vijoj mbajtjen e trajnimeve për menaxhimin të ndihmës së jashtme</p>	<p>Kurrikula e trajnimit dhe numri i zyrtarëve të trajnuar.</p>